

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri


Qershor 2019

Tiranë, më 23 Korrik 2019: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Qershor 2019, janë 1.080.464. Krahasuar me Qershor 2018, ky tregues rezulton me rritje 18,4 %. Në Qershor 2019, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 630.334. Krahasuar me Qershor 2018, ky numër është rritur me 27,0 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në gjashtëmuajorin e parë 2019 është 2.136.952, duke u rritur me 11,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Në Qershor 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Zvicra ka pasur rritjen më të madhe me 55,4 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Polonia me 7,4 %.

Në gjashtëmuajorin e parë 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Zvicra ka pasur rritjen më të madhe me 34,6 % ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Polonia me 6,4 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Qershor 2019, janë 1.103.782 duke shënuar një rritje me 23,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Qershor 2019, janë 459.567. Krahasuar me Qershor 2018, ky numër është rritur 11,8 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Qershor 2019, janë 644.215. Krahasuar me Qershor 2018, ky numër është rritur 33,0 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në gjashtëmuajorin e parë 2019, është 2.656.440 duke u rritur 10,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Qershor 2018	Qershor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Qershor 2018	Janar-Qershor 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	912.472	1.080.464	18,4	4.189.563	4.601.506	9,8
Shqiptarë	416.335	450.130	8,1	2.270.058	2.464.554	8,6
Të Huaj	496.137	630.334	27,0	1.919.505	2.136.952	11,3
Dalje Gjithsej	895.414	1.103.782	23,3	4.368.807	4.820.911	10,3
Shqiptarë	411.165	459.567	11,8	2.396.317	2.656.440	10,9
Të Huaj	484.249	644.215	33,0	1.972.490	2.164.471	9,7

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Qershor 2018	Qershor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Qershor 2018	Janar-Qershor 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	137.538	213.550.0	55,3	572.243	608.649	6,4
Maqedoni	59.272	67.767.0	14,3	262.539	276.987	5,5
Greqi	41.648	45.889.0	10,2	232.854	251.501	8,0
Itali	38.182	41.506.0	8,7	145.443	159.177	9,4
Angli	10.676	14.357	34,5	43.267	46.487	7,4
Mali i zi	28.029	37.867	35,1	185.724	190.236	2,4
Poloni	27.990	25.909	-7,4	41.624	38.974	-6,4
SHBA	15.859	17.757	12,0	42.901	48.810	13,8
Spanjë	2.766	3.620	30,9	7.400	9.247	25,0
Gjermani	14.371	20.046	39,5	49.768	59.486	19,5
Zvicër	3.230	5.019	55,4	13.963	18.797	34,6
Të tjera	116.576	137.047	17,6	321.779	428.601	33,2
Gjithsej/Total	496.137	630.334	27,0	1.919.505	2.136.952	11,3

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Qershor 2018	Qershor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Qershor 2018	Janar-Qershor 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrije Shtetas të Huaj	496.137	630.334	27,0	1.919.505	2.136.952	11,3
I. Personale	488.095	621.213	27,3	1.878.685	2.089.488	11,2
1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.	473.472	601.218	27,0	1.799.421	2.001.929	11,3
2. Trajtim shëndetësor	13	98	653,8	120	444	270,0
3. Qëllime fetare	58	63	8,6	408	465	14,0
4. Udhëtarë transit	14.552	19.834	36,3	78.736	86.650	10,1
II. Biznes dhe profesionale	8.042	9.121	13,4	40.820	47.464	16,3

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrije gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Qershor 2018	148.773	75.882	687.817	128.896	65.968	700.550
Qershor 2019	165.467	84.457	830.540	146.827	72.580	884.375
Ndryshimi vjetor (%)	11,2	11,3	20,8	13,9	10,0	26,2
Janar-Qershor 2018	643.983	228.375	3.317.205	630.529	240.086	3.498.192
Janar-Qershor 2019	708.660	261.808	3.631.038	698.242	275.379	3.847.290
Ndryshimi vjetor (%)	10,0	14,6	9,5	10,7	14,7	10,0

Metodologji

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore midsis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", neni 17 "Lehtësimi i verifikimeve Kufitare", ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.